



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.283/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj - kryesues, Arsim Hamzaj dhe Kymete Kicaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit për asamble komunale në Komunën Mitrovicë e Jugut, nga radhët e subjektit politik LDK, Muhamed Hoti, e paraqitur kundër Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 22.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

HEDHET E PALEJUAR ankesa ZL.Anr.283/2025, e datës 20.10.2025, e parashtruar nga kandidati për asamble komunale në Komunën Mitrovicë e Jugut, nga radhët e subjektit politik LDK, Muhamed Hoti, e paraqitur kundër Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datën 20.10.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën e kandidatit për asamble komunale në Komunën Mitrovicë, nga radhët e subjektit politik LDK, Muhamed Hoti, me të cilën pretendon se paraqes këtë ankesë lidhur me votat e ardhura nga diaspora për kandidaturën time në zgjedhjet e fundit të mbajtura më 12/10/2025, në listën e LDK-së, me nr.10, dega Mitrovicë. Nga komunikimi i drejtpërdrejtë me votues të diasporës që kam bërë, kam pranuar 11 konfirmime të qarta nga votues që kanë dërguar fletëvotimet përmes postës. Disa prej tyre kanë dërguar edhe fotografi dhe dëshmi të dërgimit përmes postës. Megjithatë, pas publikimit të rezultateve të numërimit të votave nga jashtë, janë regjistruar vetëm 7 vota për mua. Kjo mospërputhje ngre dyshime të arsyeshme në parregullsi. Kërkesa ime është që PZAP të urdhërojë verifikim të detajuar të fletëvotimeve të pranuar nga diaspora për subjektin dhe kandidaturën time; të identifikoni nëse ka pasur vota të refuzuara ose të pavlefshme që mund të jenë dërguar për mua; dhe të ndërmerrni veprimet e nevojshme për korrigjimin e rezultatit, nëse konstatohet parregullsi. Si provë ka bashkangjitur: listën e votuesve që kanë konfirmuar votimin nga Gjermania, përmes komunikimit (screenshot).

Në përgjigjen në ankesë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me datë 20.10.2025, ka deklaruar se me datën 03.09.2025, KQZ ka miratuar Procedurën Standarde të Veprimit për Votimin Jashtë Kosovës dhe Vlerësimin e Pakove me Fletëvotime. Në faqen 14 të kësaj procedure shpjegohet mënyra e vlerësimit të pakove me fletëvotime, ndërsa pas përfundimit të procesit të verifikimit të zarfeve me fletëvotime, DSHV dorëzon në QNR listën e votuesve të cilët kanë votuar përmes postës dhe zarfet me fletëvotime të ndara në kuti sipas komunave

të votuesve. Bazuar në nenin 17 të Rregullores Zgjedhore nr. 17/2024 për Regjistrimin dhe Votimin Jashtë Kosovës parashihet numërimi i fletëvotimeve të dërguara me postë, sipas të cilës: Fletëvotimet që janë dërguar përmes postës dhe fletëvotimet që janë hedhur në kutitë e votimit nga procesi i votimit në përfaqësinë diplomatike, numërohen në QNR. Ndërsa në nenin 20 të Rregullores Zgjedhore nr. 14/2024 për Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, parashihet procedura e numërimit të fletëvotimeve në QNR, përkatësisht, në paragrafin 9 të nenit 20 parashihet se: Zarfet e votimit me postë hapen dhe numërohen pas përfundimit të krahasimit të listave votuese të përcaktuara në nenin 18 të kësaj rregullore si dhe pas përfundimit të numërimit të votave në përfaqësi diplomatike.

Procesi i numërimit të votave në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) është zhvilluar në përputhje me Rregulloren Zgjedhore Nr. 14/2024, Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) ku ekipet e numërimit kanë bërë numërimin e votave të kandidatëve në transparencë të plotë, ku fletëvotimi është prezantuar në ekran dhe është parë nga vëzhguesit e akredituar. Krahas fletëvotimeve, në ekran është prezantuar edhe pamja e sistemit elektronik ku figurojnë numrat e kandidatëve të cilët regjistrohen në sistem.

Sa i përket pretendimeve të palëve ankuese se mbështeten në deklaratimet e personave, duhet theksuar se, në kuptim të nenit 4 paragrafi 1.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara. Publikimi i votës cenon këtë parim dhe shpërfaq vullnetin e votuesit. Nga provat e bashkangjitura, vërehet se pala ka paraqitur vetëm emra të personave në shtete të ndryshme pa specifikuar nr. e letërnjoftimit. Gjithashtu ka paraqitur edhe komunikime (screenshot), të cilat cenojnë fshehtësinë e votës dhe privatësinë e personave.

Rezultatet përfundimtare të procesit zgjedhor, shpallen nga KQZ-ja pas përfundimit të numërimit të të gjitha fletëvotimeve nga vendvotimet e rregullta; fletëvotimeve nga votimi me kusht; fletëvotimet nga votimi i personave me nevoja të veçanta; fletëvotimeve nga votimi jashtë Kosovës; vendosjes për ankesat eventuale nga PZAP dhe Gjykata Supreme dhe pas përfundimit të të gjitha procedurave në QNR, ku rezultati i publikuar është i ankimeshëm nga subjekte politike dhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numërimin e votave të tyre.

Pra, në momentin e publikimit të rezultateve përfundimtare nga, KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të LPZ, mund të ushtrojnë ankesë në afatin brenda dyzet e tetë (48) orëve në PZAP.

KQZ, ju njofton se i gjithë materiali zgjedhor duke përfshirë edhe votat me postë, gjenden në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve -QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet e drejtësisë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë gjeti se:

- Ankesa është e palejuar.

Paneli pas shqyrtimit të pretendimeve të ankuses dhe përgjigjes në ankesë të dorëzuar nga KQZ, vlerëson se pretendimi i palës ankuese se në rezultatin e publikuar nga KQZ ka marr me pak vota nga sa pretendon që ka dëshmi, nuk është pretendim i bazuar në rezultat preliminar pasi të njëjtat rezultate KQZ i ka publikuar me datë 21.10.2025, ndërsa ankesa është parashtruar me datë 20.10.2025. Duke u bazuar në faktin se rezultati preliminar është rezultat i cili mund të ndryshoj, ankesa në këtë fazë të procesit zgjedhor është e parakohshme, për shkak se pas publikimit të rezultatit përfundimtar i njëjti rezultat është i ankueshëm nga

subjektet politike edhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numrin e votave të tyre. Meqenëse në aspektin kohor, faza e procesit zgjedhor kur parashtrohet ankesa është e parakohshme ankesa duhet të hedhet poshtë si e palejueshme.

Në momentin e publikimit të rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105.1 të Ligji Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar.

Bazuar në arsyet e dhëna më lart, dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, i cili përcakton se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht”, dhe Nenit 13.3 të Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se “PZAP-i, e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim”, si paragrafi 6 i kësaj Rregullore, përcaktohet se: “në rastin kur pala ankuese paraqet ankesë për rezultatet preliminare të tabuluara nga KQZ, PZAP-i, me vendim e hedh si të palejuar ankesën”, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendosja sikurse në dispozitiv të këtij vendimi për hedhjen e ankesës si të palejueshme nuk e paragjykon rezultatin përfundimtar, e po ashtu me të njëjtat pretendime ankimore pala mund ta atakoj rezultatin përfundimtar.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, dhe 13.3 Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL.Anr.283/2025 më datën 22.10.2025

Kryesues i Panelit
Skender Çoçaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.